



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë: 9.6.2023

Nr: 665

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT, TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z. MIFTAR TAHIR DAUTI, KRYETAR BASHKIE, BASHKIA HAS, I PROPOZUAR
NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"**

Sot më datë 9.6.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, Kryetar Bashkie, Bashkia Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni "Bashkë Fitojme".

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin

Datë: 9.6.2023 Nr: 665
Ora: 12:00



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, Kryetar Bashkie, Bashkia Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni "Bashkë Fitojme"

për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte, ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtar në këshillin bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së, z. Miftar Tahir Dauti, është regjistruar si kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Për këtë kandidat, në datën 1.4.2023, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili, është regjistruar me nr. unik KU-BF-14384. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, DPB informon se kandidati në fjalë, rezulton i “rehabilituar”.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Miftar Tahir Dauti, rezulton:

- Se subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “JO”, të gjithë pyetësorit të formularit të vetëdeklarimit.

Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, i është drejtuar KQZ-së me shkresën me nr. 366/1 prot., datë 5.6.2023, me anë të së cilës na informon Instituti i Studimeve Politike kërkon verifikimin e të dhënave të plotësuar në formularin e vetëdeklarimit të z. Miftar Tahir Dauti.

Referuar kërkesës, pretendohet se z. Miftar Tahir Dauti rezulton të jetë i dënuar në shtetin Shqipëtar; rezulton të jetë i ndaluar nga organet ligjzbatuesë në shtetin e Kosovës, Serbisë dhe Shqipërisë; ka ndryshime në gjenealitete të emrit të nënës nga “Zenepe” në “Zejnepe”.

Në vlerësim të kërkesës së Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë, në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja.

Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisionit Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, Kryetar Bashkie, Bashkia Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme, për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Datë: 9.6.2023 Nr: 665
Ora: 12:00



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, Kryetar Bashkie, Bashkia Has, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”